



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 668, datë 02.11.2023

PËR

SHFUQIZIMIN E VENDIMIT TË NDËRMJETËM DATË 16.02.2023 “PËR PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT TË PROJEKTVENDIMIT PËR KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E ZNJ. {...} PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97, 98, 100 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në nenin 32 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 36/3 të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 66 të Kodit të Procedurës Administrative, në propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm datë 16.02.2023 “Për pezullimin e shqyrtimit të projektvendimit për kualifikimin/skualifikimin e znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.”
2. Vijimin e procedurës së shqyrtimit të projektvendimit për kualifikimin/skualifikimin e znj. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet znj. {...}.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi bashkë me vendimin përfundimtar që do të jepet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magjistrat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR